



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:014136

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06487101

C.nr.51/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve: F.H, M.E, M.E1, L.Sh, që të gjithë nga Rahoveci, si dhe R.K nga fshati Brestoc, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson A.M, avokat në Rahovec, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 3,275.31 euro, jashtë seance, më datën 21.11.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses L.Sh.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses L.Sh nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 114.48 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Nëntor 2022 në shumën prej 537.19 euro, në shumën e përgjithshme prej 651.67 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 12.01.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- III. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve: F.H, M.E, M.E1, që të gjithë nga Rahoveci, si dhe R.K nga fshati Brestoc, Komuna e Rahovecit.
- IV. II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses F.H nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Nëntor 2022 në shumën prej 537.19 euro, në shumën e përgjithshme prej 708.95 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 12.01.2024, deri në

pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

- V. III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses M.E nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Nëntor 2022 në shumën prej 537.19 euro, në shumën e përgjithshme prej 708.95 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 12.01.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- VI. IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses së parë M.E1 nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Prill – Nëntor 2022 në shumën prej 410.29 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 12.01.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- VII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit R.K nga fshati Brestovc, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Nëntor 2022 në shumën prej 537.19 euro, në shumën e përgjithshme prej 708.95 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 12.01.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- VIII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses F.H, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 708.95 euro e deri në shumën 757.79 euro, dhe atë në shumën prej 48.84 euro.
- IX. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses M.E, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 708.95 euro e deri në shumën 757.79 euro, dhe atë në shumën prej 48.84 euro.
- X. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses M.E1, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 410.29 euro e deri në shumën 439.47 euro, dhe atë në shumën prej 29.18 euro.

- XI. REFUZOHET REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit R.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 708.95 euro e deri në shumën 757.79 euro, dhe atë në shumën prej 48.84 euro.
- XII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve ti paguaj shumën prej 333.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësit: F.H, M.E, M.E1, L.Sh, që të gjithë nga Rahoveci, si dhe R.K nga fshati Brestovc, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë me datë 12.01.2024, përmes të autorizuarit të tyre A.M, avokat në Rahovec, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të nenit 36 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, me numër të protokollit 105, të nënshkruar me datë 22.01.2021 si dhe nenit 90 të Ligjit të Punës i Kosovës, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor për vitin 2021, 2022. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, me datën 04.11.2024 përmes parashtresës ka bërë precizim dhe plotësimin e padisë për paditësen e katërt L.Sh.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 26.06.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK.

Paditësit kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 12.01.2024, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësve është parashkruar në tërësi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shume se 3 vite. Në bazë të nenit 87 të Ligjit të punës “Të gjitha kërkesat në para nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat pre tre (3) vitesh.

Enjëjta ka theksuar që paditësja M.E1 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë tjetër për kompensim në emër të inflacionit vjetor me nr. C.nr. 49/2024, me numër të lëndës: 2024:013376, ashtu që i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësës ta hedhë poshtë si të palejuar për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë - litispedencës, konform nenit 391 pika c) të LPK-së.

Paditësit me padi kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të inflacionit me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë, të cilën e konteston në tërësi, sepse konsideron se kamata duhet të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, respektivisht nga dita kur paditësve u njihet

e drejta e kompensimit, kur edhe e paditura kupton në bazë të aktgjykimit lidhur me detyrimet financiare që i ka ndaj paditësve. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Isa Boletini”, në Rahovec. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve F.H, M.E, L.Sh si dhe R.K, është në shumën prej 421.00 euro, ndërsa paditësja M.E1 është në shumën prej 393.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve F.H, M.E, M.E1, L.Sh, si dhe R.K, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.

265/2020 të datës 12.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë si më lartë, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësit gjatë vitit 2022, përfitojnë ngritje në bazë të inflacionit për njëmbëdhjetë (11) muaj, e jo për dymbëdhjetë (12) muaj, siç kanë kërkuar në padi, pasi që edhe pse më datën 22.01.2021 është lidhur Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, njëra palë kontraktuese më datën 22.11.2022 është tërhequr nga zbatimi i kësaj Kontrate Kolektive. Në këtë Kontratë Kolektive kanë qenë të parapara edhe hapat e kontestimit të shkëputjes së kësaj Kontrate, mirëpo nga pala tjetër nënshkruese nuk janë paraqitur prova me të cilën do ta dëshmonin se është kontestuar vlefshmëria e Kontratës Kolektive. Këtë qëndrim e mban edhe Gjykata Supreme e Kosovës, e cila në mendimin e saj juridik me numër 214/2023 të datës 05.10.2023, ka theksuar se *“Në rrethana të tilla, kjo gjykatë vlerëson se rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga kjo kontratë duhet trajtuar sipas kësaj kontrate dhe atë deri me datën 21.11.2022, kur është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese, marrë për bazë arsyet e paraqitura më lartë”*.

Gjykata vlerëson se baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore nuk është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 12.01.2024.

Sa i përket pretendimeve të paditurës Komuna e Rahovecit – DKA që paditësja M.E1 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë tjetër për kompensim në emër të inflacionit vjetor me numër C.nr. 49/2024, me numër të lëndës: 2024:013376, gjykata ka gjetur që përfaqësuesi i autorizuar i paditëses me datë 04.11.2024 me parashtrësë e ka njoftuar gjykatën që për paditësen M.E1 në padinë C.nr.49/2024, nuk ka kërkuar kompensim në emër të inflacionit pasi që është në zhvillim e sipër kërkesëpadi C.nr.51/2024.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadi është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadi qartazi janë*

në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 333.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 21 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 312.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.51/2024, më datën 21.11.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.